



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KRYETARI

Nr. 798 Prot

Roskovec, më 03. 02 2023

**SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE  
PËR POZICIONIN**

**PUNONJËS NË POLICINË BASHKIAKE ROSKOVEC**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; të ligjit Nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar); nenit 11 të Rregullores së brendshme “Tip” të policisë së bashkisë dhe komunës; VKM-së Nr. 525, datë 11.9.2018, “Për disa ndryshime në vendimin Nr. 313 datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpezimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 97, datë 23.12.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarrjeve vartëse për vitin 2023”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 98, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarrjeve vartëse të bashkisë për vitin 2023”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresë nr. 02/1 prot. datë 06.01.2023; Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Roskovec Nr. 11, datë 16.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat Përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum, si dhe organigramës për vitin 2023”, Bashkia Roskovec shpall procedurën e konkurimit për vend të lirë pune,

**Punonjës i policisë bashkiake, (1 polic)**

**Kandidatët për polic duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm;
- Të jetë i moshës nga 19-27 vjeç;
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
- Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
- Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;
- Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit dhe të mos ketë qënë i dënuar për shkelje të rënda dhe vepra penale;

**DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë; \*

- Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
- Curriculum Vitae;
- Fotokopje e Kartës së Identitetit;

- d- Çertifikatë e përbërjes familjare;
- e- Librezë ushtarake ose vërtetim nga dega e mobilizimit ushtarak;
- f- Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
- g- Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
- h- Fotokopje e librezës së punës.
- i- Motivacioni i largimit nga puna e fundit (në se është i punësuar ose ka qenë i punësuar);
- j- Raport mjeko-ligjor për ushtarakë;
- k- Vërtetim i gjendjes Gjyqësore;
- l- Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces hetimi);
- m- Vërtetim nga Gjykata (që nuk është aktualisht në proces gjyqësor);
- n- Vërtetim nga Drejtoria e Tatim-Taksave (që nuk është person fizik dhe juridik);
- p- 2 Fotografji (një copë 9 x 6 cm dhe një copë 2.5 x 3.5 cm).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose në Sektorin e Zyrës me Një Ndalesë të bashkisë Roskovec, brenda datës 13.02.2023.

## **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT**

Në datën 15.02.2023, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Roskovecit do të shpallë në në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec, në standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet testimi. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec. Afati i ankimit është **2 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

## **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- b- Njohuritë mbi ligjin nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar);
- c- Njohuritë mbi Rregulloren së Brendshme “Tip” të policisë së bashkisë dhe komunës;
- d- Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.

## **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

**Kandidatët në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është	<b>25 pikë</b>
Vlerësimi maksimal për testimin me shkrim është	<b>45 pikë</b>
Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është	<b>30 pikë</b>

**Kandidatët që marrin 60% (27 pikë) të pikëve të testimit me shkrim, kanë të drejtë të vazhdojnë fazën e intervistës me gojë.**

**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, (testimit me shkrim dhe intervistës me gojë) Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Roskovecit do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec në stendat e informimit të publikut dhe në stendat pranë Policisë Bashkiake. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec. Afati i ankimimit është **5 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.

**KRYETARI**  
**Majlinda Bufi**

